

# Thirrje për kuotim

## Furnizim me veshëmbathje pune

(xhaketa, pantallona, xhaketa shiu, kapela, dorëza, syze mbrojtëse, këpucë pune)

I/e nderuar,

Ftoheni të ofertoni lidhur me aktivitetin e prokurimit të cekur në titull në përputhje me kërkesat e kësaj thirrje.

Kuotimin (ofertën) Tuaj ju lutem e dërgoni në email adresën: [procurement@dplus.org](mailto:procurement@dplus.org). Afati i fundit për ofertim është **31 mars 2023, ora 14:00**.

Ofertën Tuaj e dorëzoni duke përdorur formën në këtë thirrje.

Me respekt,

Democracy Plus

## Për D+

Democracy Plus (D+) është një organizatë e pavarur, jofitimprurëse, e themeluar nga një grup aktivistësh të cilët besojnë fuqishëm në vlerat demokratike dhe në një Kosovë demokratike. Qëllimi kryesor i organizatës sonë është të mbështesë vlerat dhe praktikat demokratike në fushën e qeverisjes së mirë, sundimit të ligjit, zgjedhjeve dhe partive politike, çështjeve sociale dhe të drejtave të njeriut.

## Sfondi

D+ zbaton *Aktivitetin e USAID-it Riciklimi ka rëndësi – Graçanicë* që synon të rrisë kohezionin socio-ekonomik në mes të komuniteteve Romë, Ashkali dhe Egjiptian që angazhohen në grumbullimin joformal të mbeturinave, të sektorit privat, të të rinjve dhe të komunës së Graçanicës, duke krijuar modele të qëndrueshme të riciklimit në bashkëpunim me të gjitha grupet e synuara.

## Objektiva e thirrjes

D+ synon që për nevoja të përfituesve të projektit të furnizohet me veshmbathje dhe pajisje mbrojtëse për mbledhësit e mbeturinave sipas planit në vijim:

### 1. Pantallona pune verore

Pantallona pune të papërshkueshëm nga uji - dizajn modern, të prodhuara nga një kombinim materiali afërsisht 65% poliestër dhe 35% pambuk. Pantallonat të kenë përforcime në gjunjë për rritjen e rezistencës ndaj konsumit. Të kenë krahosha. Pjesa e përparme e epërme të ketë një xhep të madh të mbyllur me zingjir, pjesa e poshtme të ketë dy xhepa anësore si dhe një xhep të lëshuar në anën e djathtë të këmbës për mjete. Lehtë dhe komode për t'u veshur në kushtet e motit më të ngrohtë. Mbyllësi me patent. Të ketë elemente reflektuese si dhe të jenë në përputhje me ISO 13688:2013

Ngjyra: e kaltër e mbylltë

Sasia: 50 copa total nga madhësitë si në vijim: M, L, XL, XXL

### Foto ilustrative



## 2. Xhaketa pune verore

Të prodhuara nga një kombinim afërsisht 65% polyester dhe 35% pambuk, rezistent ndaj ujit. Të mbërthehet apo mbyllet me patent i cili duhet të jetë i mbuluar me shirit. Të ketë së paku 4 xhepa. Në pjesën e epërme të ketë dy xhepa me mbulesë dhe pjesa e poshtme të ketë dy xhepa me hyrje të përforcuar. Të ketë elemente reflektuese deri 5cm gjerësia e shiritit. Të ketë brez elastik i belit, si dhe të jenë në përputhje me ISO 13688:2013

Ngjyra: e kaltër e mbylltë

Sasia: 50 copa total nga madhësitë si në vijim: M, L, XL, XXL

### Foto ilustrative



## 3. Xhaketa shiu

Xhaketa duhet të jetë e papërshkueshme nga uji (100% poliester, me shtresë poliuretani), gjatësia 120 cm, dhe të ofrojë mbrojtje nga era si dhe prerje të zgjatur. Xhaketa e shiut duhet të posedoj një kapele mbrojtëse nga shiu që mund të shtrëngohet rreth fytyrës me një kordon tërheqjeje, mundësisht që mund të paloset kur nuk është i nevojshëm. Poashtu, duhet të posedojë dy xhepa të gjerë përpara me rrathë që pengojnë hyrjen e ujit në to.

Ngjyra: e verdhë me elemente reflektuese

Sasia: 50 copa total nga madhësitë si në vijim: M, L, XL, XXL

### Foto ilustrative



#### **4. Kapele pune**

Kapele pune industriale me dizajn sportiv. Kapela duhet të jetë prej ABS, dhe materiali kryesor të jetë një përzierje afërsisht prej 70% pambuku dhe 30% poliestër. Te jetë me mbushje të butë EVA për rehati më të madhe. Rregullimi i perimetrit të jetë me një brez elastik si dhe e disponueshme në dy variante të gjerësisë - 25 mm dhe 55 mm.

Ngjyra: e kaltër e mbylltë

Sasia: 50 copa total nga madhësitë si në vijim: M, L, XL, XXL

#### **Foto ilustrative**



#### **5. Dorëza pune**

Dorëza me material pambuku, të qëndrueshme dhe të mbështjella me material gome me shtresë të pa rrëshqitshme. Preferohet që mansheta të jetë me perimetër i cili rregullohet me Velcro.

Sasia: 100 copa total nga madhësitë si në vijim: M, L, XL, XXL

Ngjyra: e kaltër e mbylltë

#### **Foto ilustrative**



## 6. Syze sigurie

Syze sigurie të pastra me një dizajn modern sportiv dhe shumë të lehta. Lentet optike duhet të jenë prej polikarbonatit të klasit 1, të ofrojnë mbrojtje kundër ndikimeve të grimcave me shpejtësi të ulët deri në 45 m/s, edhe në temperatura ekstreme. Duhet të posedojnë një shtresë të veçantë që parandalon gërvishtjet dhe mjegullimin.

Sasia: 50 palë

### Foto ilustrative



## 7. Këpucë pune

Këpucë pune të cekëta me mbrojtje në taban, të papërshkueshme nga uji. Pjesa e sipërme e këpucës të jetë nga lëkura e pigmentuar dhe të jetë e papërshkueshme nga uji. Pjesa e brendshme e këpucës të jetë prej: Rrjetes poliamide me mbrojtje, shtresa (Insock): Poliamide antibakteriale. Këpuca duhet të jetë me veti kundër rrëshqitjes, dhe duhet të përmbushë standardin: S1P (që siguron mbrojtje efektive ndaj lëndimeve).

Sasia: 50 palë total nga madhësitë si në vijim: 36-48

Ngjyra: e zezë

### Foto ilustrative



## Procedura për aplikim dhe kushtet e përgjithshme

### **Specifikimet teknike të detyrueshme**

Furnizimet duhet të jenë në pajtim apo së paku njësoj me specifikimet teknike të parashtruara në këtë Thirrje për Kuotim, dhe në përputhshmëri në të gjitha aspektet tjera si: sasitë, modelet, mostrat e dorëzuara, matjet dhe udhëzimet tjera. Për çdo kërkesë duhet të ofrohet dëshmi.

Democracy Plus rezervon të drejtën që të kërkojë mostrat e produkteve, si kusht për të vazhduar negocimin dhe nënshkrimin e kontratës. Cilido specifikim që nuk është në përputhshmëri me specifikimet teknike do të diskualifikoj ofertuesin.

Ofertuesit mund të dorëzojnë ofertë që propozon ndonjë furnizim i cili është në pajtueshmëri me një variant të specifikimeve teknike, që ofron zëvendësim, kualitet ose standard më të lartë se kërkesat teknike.

### **Pyetjet dhe sqarimet**

Pyetjet mund të dërgohen në mënyrë elektronike tek [procurement@dplus.org](mailto:procurement@dplus.org) më së voni deri me datën 27 mars 2023.

### **Validiteti i ofertave**

Periodha minimale e vlefshmërisë së ofertave duhet të jetë 45 ditë nga data e ofertimit.

### **Përshtatshmëria**

Thirrja është e hapur për kompanitë ose furnizuesit e regjistruar në Kosovë të cilët funksionojnë në bazë të ligjeve të aplikueshme të Kosovës, si dhe posedojnë mallin që i plotëson kualifikimet e paraqitura më sipër.

### **Kriteret e përzgjedhjes**

Çmimi më i ulët, teknikisht i pranueshëm, për ofertues të përgjegjshëm.

### **Kushtet dhe kërkesat e dërgesës**

Dërgimi i pajisjeve duhet të bëhet në Qendrën Burimore në Graçanicë ose në zyret e Democracy Plus. Liferimi i mallit bëhet në bazë të kontratës në mes të Democracy Plus dhe furnitorit.

Afati i fundit për dërgimin e furnizimit është 30 prill 2023.

### **Pagesa**

Democracy Plus do të përgatisë një kontratë për furnizime, në bazë të ofertës dhe negocimit eventual. Pagesa do të bëhet më së largu 30 ditë pas dorëzimit të furnizimit.

### **Dispozita e anulimit**

Në rast anulimi të kërkesës për furnizim, do të jepet një njoftim paraprak prej katër ditësh dhe nuk do të paguhet asnjë tarifë anulimi. Pagesa do të bëhet për shërbimet e përdorura apo furnizimet e bëra deri në njoftim.

### **Kostot për përgatitjen e ofertave**

Të gjitha kostot që lidhen me përgatitjen, dorëzimin ose negocimin e ofertave në përgjigje të kësaj thirrjeje janë nën përgjegjësinë e ofertuesit. D+ nuk rimbursen asnjë kosto të tillë.

## Forma e dorëzimit të kuotimit

Ju lutemi që ofertën tuaj ta organizoni në këtë mënyrë:

NR	PËRSHKRIMI	NJËSIA	CMIMI PËR NJËSI	TOTAL
1	PANTALLONA PUNE	50		
2	XHAKETA PUNE	50		
3	XHAKETA SHIU	50		
4	KAPELE PUNE	50		
5	DOREZA PUNE	100		
6	SYZE SIGURIE	50		
7	KEPUCE PUNE	50		
			<b>TOTAL</b>	

Çmimet duhet të jenë pa TVSH. Democracy Plus do të sigurojë certifikatën e lirimit nga TVSH.

### Dokumentet që duhet të dorëzohen me këtë kuote

- Certifikata e regjistrimit dhe numri fiskal
- Dëshmi nga ATK që kompania nuk ka borxhe të papaguara
- Dëshmi nga gjykata që kompania nuk është nën hetime
- Dëshmi të cilësisë (standardet ISO)

Nënshkrimi i personit të autorizuar \_\_\_\_\_

Emri dhe pozita e personit që nënshkruan \_\_\_\_\_

Data \_\_\_\_\_

Emri dhe adresa e kompanisë \_\_\_\_\_